

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. _____

Tirane, me ____ .10.2001

URDHËR

I

PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

Nr. 138, Date 22. 10. 2001

"Për krijimin e strukturës për drejtimin e hetimeve te procedimeve lidhur me grup veprash penale te renda".

Sot me date 22. 10. 2001, unë Arben Rakipi, Prokuror i Përgjithshëm i Republikës, me qëllimin për te rritur efikasitetin e ndjekjes penale ndaj një grup krimesh te renda; për t'ju përgjigjur nevojave të luftës ndaj trafikëve që zhvillohen në vend; për te përshtatur strukturat e prokurorisë me ato analoge në juridiksione të tjera apo edhe me ato të policisë në vend; për te shmangur presionet ndaj prokuroreve, oficerëve të policisë që jo rrallë vihen në rrethë; për te eliminuar familjaritetin që ndonjëherë vihet në fenomenet kriminale masive të përhapura në rrethë të caktuara; për të përpunuar dhe evidentuar me bankën e të dhënave dokumentacionin që lidhet me krimin e organizuar, që bën të mundur kërkimin e marrjes së masave parandaluese për këto fenomene; për te specializuar strukturat në luftë ndaj krimeve

te këtij lloji, bazuar ne nenin 9/2 te ligjit Nr. 8737, date 12.02.2001
"Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e
Shqipërisë"

URDHËROJ:

1. Ne Prokurorinë e Përgjithshme krijohet drejtoria e veçante qe do te drejtoje, kontrolloje apo zhvilloje hetimet ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, lidhur me disa krime te renda, te përshkruara ne ketë urdhër.
2. Kompetenca lëndore e këtij grupi do te shtrihet mbi veprat penale te parashikuara nga këto dispozita te K. Penal:

nenet 86; 89/a; 109; 109/a; 110/a; 114; 114/a; 114/b; 115; 128/b; 141/a; 143/a; 171; 172; 175; 177; 180; 181; 181/a; 248; 252; 253; 256; 257; 258; 259; 260; 278/a; 283; 283/a; 283/b; 284/b; 284/c; 284ç; 285; 285/a; 286; 286/a; 287; 287/a; 297; 298; 313; 313/a; 314; 315; 319; 333; 334.

3. Çdo procedim filluar me kualifikimin ligjor sipas njërës prej dispozitave te mësipërme, do te vlerësohet rast pas rasti nëse do te mbahet ne Prokurorinë e Përgjithshme për te drejtuar hetimet, Kriteret e vlerësimit do te jene, rëndësia e çështjes, shtrirja e saj ne kohe dhe territor, demi i shkaktuar, numri i te implikuarve, dhe lidhjet me juridiksionet e tjera.
4. Janë kompetence e këtij grupi edhe krimet me te renda te kryera si pasoje e trafikeve te paligjshme si dhe, procedimet e tjera te lidhura.

5. Autorizohen prokuroret e Rretheve te kryejnë veprimet procedurale për llogari te procedimeve ne kompetence te këtij grupi, ne rastet e urgjencës apo kur shihet e domosdoshme nga drejtori i Drejtorisë se hetimit te krimit te organizuar.
6. Prokuroret e rretheve, kur vërejnë qe procedimet përpara tyre, kualifikohen ne njëren prej dispozitave te cituara ne piken 2 te këtij urdhri, ndërpresin veprimet dhe ia dërgojnë menjëherë materialet Prokurorisë se Përgjithshme.
7. Procedimet e ardhura nga juridiksione te huaja si rezultat i plotësimit te letërporosive apo shkëmbimit te informacioneve, janë kompetence e Drejtorisë se hetimit te krimit te organizuar.
8. Ky urdhër t'u shpërndahet, Drejtorisë përkatëse, dhe gjithë Prokurorive te Rretheve.
9. Urdhri hyn ne fuqi me date 1.11.2001.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

Arben RAKIPI



